



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1043/2 prot.

Tiranë, më 20. 09. 2021

V E N D I M

Nr. 175, datë 20. 09. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 54, datë 01.04.2021, të L. Sh., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”¹ nga ana e Postës Shqiptare sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, L. Sh. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të saj, Posta Shqiptare sh.a., duke i dhënë masën disiplinore “*Ulje në detyrë*”. Mbështetur në aktet e vëna në dispozicion bashkëngjitur ankesës, L. Sh. është emëruar ekonomiste në Administratën e Postës Shqiptare sh.a. dhe ka vijuar të punojë në këtë institucion që prej vitit 1986.

Me Urdhërin Nr. 282, datë 21.10.2019, të Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., ndaj ankuseses është marrë një masë disiplinore “*Ulje në detyrë*”. Sipas ankuseses, kjo masë disiplinore ka qenë e paralajmëruar për të, pasi drejtuesit e Partisë Socialiste në Shkodër, i kanë bërë presion në mënyrë të vazhdueshme drejtuesve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., për largimin e saj nga puna. Kjo ka ardhur për shkak të bindjeve dhe angazhimit politik të saj dhe bashkëshortit në subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

Për masën e dhënë, ankuesja pretendon se më datë 28.10.2019, ka paraqitur ankim tek punëdhënësi, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Sipas L. Sh., në urdhërin e sipërcituar, nuk është

¹ Referuar vërtetimit të lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, Koordinatorit Politik për Qarkun Shkodër, L. Sh. është pjesë e strukturave politike lokale të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, që nga viti 2017.

përcaktuar asnjë shkelje apo arsye për të cilën është ndëshkuar me masë disiplinore. Sipas punëdhënësit, masa e dhënë është mbështetur në gjetjet e Auditimit të kryer dhe rekomandimet e lëna, por ajo nuk ka marrë dijeni nëse është rekomanduar ndonjë masë për të.

Në vijim ankuesja pretendon se është zëvendësuar menjëherë me një punonjëse tjetër, e cila sipas saj është pa eksperiencën e nevojshme në punë dhe militante e Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. për shkak të bindjeve politike dhe rikthimin e saj në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. NËPËRMJET shkresës me nr. 577/1 prot., datë 07.04.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues² Postës Shqiptare sh.a., lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më sipër, Posta Shqiptare sh.a., me anë të shkresës³ nr. 785/1 prot., datë 16.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “... L. Sh. e emëruar me detyrë ‘Kryetare e Degës së Shërbimeve dhe Marketingut’, ka marrë masë disiplinore referuar Auditimit të plotë ekonomik financiar dhe të shërbimeve të kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a., dhe jo për shkak të bindjeve politike, siç pretendon ankimuesja. Posta Shqiptare është një kompani, në të cilën është e ndaluar çdo formë diskriminimi për punonjësit e saj, e parashikuar në Kodin e Punës dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Masa disiplinore ‘Ulje në detyrë’, është marrë nga Administratori i Shoqërisë, pasi shqyrtoi ‘Rekomandime për masa disiplinore’, me nr. 236/B, datë 16.06.2019, mbi Auditimin e kryer në Filialin e Postës sh.a., Shkodër, dhe kjo i është komunikuar nga Drejtoria e Filialit. L. Sh. ka marrë vërejtje për përsëritje të gjetjeve, në mënyrë të veçantë mos vlerësimi i rrishtit dhe mos funksionim i Kontrollit të Brendshëm në disa shërbime me rrisht të lartë, siç janë:

- Shërbimi i pagesës së pensioneve në kundërshtim me marrëveshjen m. 1932 prot., të Posta Shqiptare sh.a., datë 21.08.2008, pika 2, me manualin në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ‘Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’, të ndryshuar, pika 3.3, si dhe në kundërshtim me Rregulloren e Shërbimit Financiar e Bankar, pika 22.2 dhe 22.4.
- Në shërbimin postar, si mangësi, konstatohen raste ku objektet postare për popullatën janë tërhequr nga të tretë pa specifikuar lidhjen familjare, në kundërshtim me Rregulloren e Shërbimit Bazë Postare, Neni 37 Shpërndarja e objekteve, gërma c.
- Shërbimi i arkëtimit të faturave për OSHEE. Shërbimi i pagesës për ndihmën ekonomike, invaliditetin e tjerë rezulton se nuk zbatohen kërkesat e Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 ‘Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore’. Gjithashtu edhe për punë të pamjaftueshme për arritjen e objektivave tek të ardhurat që ndikojnë direkt në treguesit ekonomik - financiar.

Lidhur me emërimin në pozicionin që ka mbajtur më parë L. Sh. është emëruar O. M., e cila ka përfunduar Fakultetin Ekonomik, dega Financë - Kontabilitet në vitin 2013, si dhe studimet Master Shkencor në Fakultetin Ekonomik, në vitin 2015, dhe është punonjëse prej vitit 2017 në Filialin e Postës Shkodër. O. M. ka qenë e emëruar me detyrë “Specialiste e Shërbimeve Financiare”,

² Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me masën disiplinore të dhënë ndaj ankueses.
- Kopje e vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Kopje të Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., të kryer në Filialin e Postës Shkodër (pjesën në të cilën rekomandohen dhënia e masave disiplinore për punonjësit e këtij Filiali).
- Informacion nëse është dhënë masë disiplinore ndaj punonjësve të tjerë të Filialit të Postës Shqiptare Shkodër. Nëse po, kopje të akteve përkatësve të masave disiplinore.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit (procedurën e emërimit, arsimimi i tij/saj, përkrahimi i punës dhe kërkesat e pozicionit të punës), nëse ka patur punonjës të emëruar në pozicionin që ka mbajtur më parë L. Sh.

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 577/2 prot., datë 20.04.2021

përpara emërimit në detyrë dhe nuk është ashtu siç pretendon L. Sh. pa eksperiencë, pasi ajo ka qenë pjesë e punonjësve të kompanisë Posta Shqiptare sh.a. Kompania Posta Shqiptare operon duke i promovuar punonjësit e saj, dhe duke kryer qarkullim të brendshëm të punonjësve.

- Për sa i përket vlerësimeve të punës të tre viteve të fundit nuk disponojmë. Theksojmë se L. Sh. ka marrë masa disiplinore në mënyrë të përsëritur, në vitin 2015 L. Sh. ka marrë 'Vërejtje me shkrim', referuar Vendimit të Drejtorisë Nr. 310, datë 30.11.2015 'Mbi Auditimin e pjesshëm ekonomiko-financiar të Filialit Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Korçë e Lezhë'.
- Gjithashtu në vitin 2018 L. Sh., ka marrë masë disiplinore 'Vërejtje me paralajmërim', referuar Vendimit të Drejtorisë së Shoqërisë nr. 17, datë 15.01.2018 mbi 'Auditimin e plotë ekonomiko-financiar dhe të shërbimeve të kryera në Filialin e Postës sh.a., Shkodër'.
- Masa disiplinore nga grupi i auditimit janë dhënë dhe për punonjësit: E. V. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse; L. L. me detyrë Kryetare e Zyrës Qendër; E. P. me detyrë Kryetare e Degës së Postës Pukë, dhe Xh. P. me detyrë Specialiste Shërbimesh në Degën e Postës Pukë.
- L. Sh. është emëruar Kryetare e Degës së Shërbimeve dhe Marketingut, referuar Vendimit të Drejtorisë nr. 522, datë 04.12.2013 'Lirime dhe emërimë në detyrë në Filialin e Postës Shkodër'.
- Përpara emërimit të L. Sh. si Kryetar i Degës së Shërbimeve dhe Marketingut, ka qenë i emëruar P. Z., i cili ka përfunduar Universitetin e Tiranës, Fakultetin Ekonomik, Dega Financë. P. Z. ka punuar pranë Filialit të Postës Shkodër me detyrë kontrollor shërbimesh nga viti 1997-1998 e deri në vitin 2003 ka qenë i emëruar Llogaritar i Parë. Për sa më sipër janë evidentuar dhe në Raportin e Auditimit në të cilën është vënë në dijeni ankuesja...".

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Posta Shqiptare sh.a., vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Shkresën e emërimit të L. Sh. me nr.2993/1 prot., datë 03.12.2013, dhe shkresën 3067/1 prot., datë 09.12.2013.
- Auditimin e Filialit të Postës Shkodër, pjesën e Shërbimeve dhe Marketingut (nga faqja 8-13 dhe pjesën e Rekomandimeve).
- Vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë nr. 17, datë 15.01.2018 mbi "Auditimin e plotë ekonomiko-financiar dhe të shërbimeve të kryera në Filialin e Postës sh.a., Shkodër".
- Raporti Final i Auditimit, pjesa ku i ka kaluar Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut me firmë.
- Vendimin e Drejtorisë Nr. 310, datë 30.11.2015 "Mbi Auditimin e pjesshëm ekonomiko-financiar të Filialit Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Korçë e Lezhë".
- Masa disiplinore nr. 212/1 prot., datë 24.01.2018 "Dërgohen masa disiplinore për zbatim në Filialin e Postës sh.a. Shkodër".
- Masat disiplinore në Filialin e Postës Shkodër për L. Sh., Urdhër Nr.282, datë 21.10.2019; për L. L., Urdhër Nr. 283, datë 21.10.2019; për E. V., Urdhër Nr. 281, datë 21.10.2019; për E. P., Urdhër Nr. 279, datë 21.10.2019; për Xh. P., Urdhër Nr. 280, datë 21.10.2019.

- Detyrat dhe kompetencat e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut.
2. Me anë të e-mail-it datë 16.04.2021, ankuesja iu drejtua Komisionerit duke i vënë në dispozicion disa parashtrime sa i përket pretendimit për diskriminim, si më poshtë vijon:
- *Lidhur me masën disiplinore të dhënë ndaj meje nuk është ndjekur procedurë konform Rregullores së Auditimit .*
 - *Njoftimi për masën e dhënë është bërë me Urdhërin e Brendshëm nr. 1229, datë 23.10.2019, të Filialit Shkodër në zbatim të urdhërit nr. 282, datë 21.10.2019 të Administratorit të Postës Shqiptare sh.a. Jam befasuar nga njoftimi për masën e dhënë sepse megjithë presionin e ushtruar nga drejtuesit e Partisë Socialiste në Shkodër, administratori i kompanisë L. D. vlerësonte profesionalizmin, kontributin institucional dhe performancën time në punë, këtë e ka shprehur disa herë në takimet e punës që kemi patur (gjë që mund të konfirmohet nga vetë personat), për këtë më kishte garantuar se nuk ndikohej.*
 - *Pas njoftimit të marrë kam takuar administratorin, ku i kam kërkuar arsyet për masën e dhënë dhe është shprehur se kërkohen drejtues të rinj, kur unë jam shprehur për profilin e ulët profesional të personit që do më zëvendësonte (gjë që do kishte impakt në punë) më ka thënë që bëj ankimim të vendimit dhe për një kohë të shkurtër do e rishqyrtoj.*
 - *Vlerësime për punën e punonjësve të administratës dhe fuqisë punëtore nuk janë bërë nga struktura e ngarkuar, gjë që është lënë detyrë. (shih rekomandimin nr. 29 të rap. final).*
 - *Në raportin final të auditimit në të cilin referohet masa e dhënë nuk ka patur vendim (urdhër) për dhënien e masave disiplinore. (shif dokumentat e arshivuara në maj 2019).*
 - *Nuk ka patur procedurë (p.sh. konkurim, testim, vlerësim) për emërimin në pozicionin e punës që unë kam mbajtur, por direkt emërim me urdhërin nr. 297, datë 31.10.2019 të O. M., e cila ka filluar punë Filialin Shkodër në dhjetor të vitit 2017 (më pak se dy vite eksperiencë pune) si specialiste në shërbimin financiar, suporti për formim e saj profesional është bërë nga ana ime.*
 - *Për sa jam shprehur në ankimim se largimi ka qenë i paralajmëruar mbasi **drejtuesit e Partisë Socialiste kane bërë presion në mënyrë të vazhdueshme** drejtuesve të Posta Shqiptare sh.a.*
 - *Sqaroj se për këtë jam vënë në dijeni nga drejtuesi i filialit i cili më ka shprehur në zyrë kërkesën që i është bërë atij nga deputetë të Shkodrës në mënyrë verbale për largimin tim (nëse është e nevojshme mund të cilësoj personat).”*
3. Për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 577/3 prot., datë 11.06.2021 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 28.06.2021, ora 10:00. Gjithashtu, ditën e realizimit të seancës dëgjimore, Komisioneri

kërkoj nga Posta Shqiptare sh.a., të vëre në dispozicion të shqyrtimit të çështjes informacion⁴ shtesë.

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë vetëm të palës ankuese, L. Sh.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e Komisionerit gjatë seancës dëgjimore, subjektit ankues iu kërkua nëse mund të vinte në dispozicion prova dhe fakte sa i përket pretendimit të saj, se nga ana e përfaqësuesve politik të Partisë Socialiste Shkodër, është kërkuar largimi i nga pozicioni i punës.

4. Me e-mail-in datë 06.07.2021, Komisioneri vuri në dispozicion të ankueses përgjigjen e Postës Shqiptare sh.a., sa i përket pretendimeve të ngritura prej saj.

Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar, ankuesja me e-mail-in datë 26.07.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...nga ana e Postës Shqiptare sh.a., duhet të ishin paraqitur: kopje e vendimit për masat disiplinore , kopje e shkresës përcjellëse dhe kopje të dokumentit që konfirmon komunikimin nga Drejtoria e Filialit të vendimit për masat disiplinore punonjësve përgjegjës.*

Nëse është vepruar kështu shtrohet pyetja, përse Urdhëri i brendshëm për dhënie mase disiplinore ka dalë përsëri katër muaj pas përmbjlljes së procedurës së auditimit nr. 282, datë 21.10.2019 dhe më është paraqitur më datë 23.10.2019 me urdhër nr. 1229.

Gjithashtu, vë në dukje që sipas Rregullores së procedurës së auditimit, Vendimi për dhënien e masave administrative, disiplinore është një akt i vetëm, ndërsa në Auditimin e realizuar për vitin 2018-2019 ka disa akte të veçanta.

Me masat disiplinore të dhëna për punonjësit e tjerë të Filialit Shkodër unë u njoha nga aktet që ishin dërguar bashkëngjitur shkresës, nuk janë komunikuar.

Në shkresë thuhet se masa e dhënë ndaj meje bazohet në gjetje të përsëritura në mënyrë të veçantë në disa shërbime me risk të lartë siç është shërbimi i pagesës së pensioneve, ndihmës ekonomike,

⁴ - Informacion dhe kopje të akteve, lidhur me procedurën që ndiqet për dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

- Kopje të kontratës së punës së lidhur me L. Sh. (nëse ka) dhe kopje të kontratës kolektive.
- Informacion lidhur me procedurën e parashikuar nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., sa i përket dhënies së masave disiplinore për punonjësit e saj, si dhe aktin në të cilin janë parashikuar masat disiplinore.
- Kopje të akteve, nëse nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., janë marrë masa disiplinore për ulje në detyrë, për punonjës të tjerë të cilët janë konstatuar në shkelje nga ana e Auditit të Brendshëm të Shoqërisë.
- Informacion nëse Auditimi i Brendshëm i Shoqërisë, është organi që rekomandon masa disiplinore ndaj punonjësve kur nga kontrolli i tij konstatohen në shkelje apo kjo procedurë ndiqet nga ana e Drejtorisë së Shoqërisë.

invaliditetit, arkëtimet të faturave të OSHE-së dhe në shërbimin postar. Gjithashtu, për punë të pa mjaftueshme për arritjen e objektivave tek të ardhurat.

Për këto gjetje të pretenduara nuk paraqitet asnjë dokument (proces-verbal, akt konstatim apo etj.) që vërteton me fakt gjetjen shkeljen që unë mbaj përgjegjësi sipas detyrave që më ngarkon pozicioni i punës.

Në zbatim të Rregullores së procedurës së auditimit gjetjet e konstatuara të shoqëruara me fakte duhet ti bëhen me dije personave përgjegjës në takimin përmbyllës, ballafaques, për ti dhënë mundësinë të shprehen me argumenta pro apo kundër, gjë e cila nuk është bërë.

Gjithashtu, për sa i përket gjetjeve sqaroj se, Filiali i Postës Shkodër kryen aktivitet në gjithë qarkun e Shkodrës me një rrjet prej 41 zyra postare, gama e shërbimeve që kryen është mbi 100 dhe volumi shërbimeve është i konsiderueshëm mesatarisht 300 mijë veprime në muaj...

Në gjithë këtë veprimtari për gjithë periudhën që unë drejtoj sektorin e shërbimeve në kontrollet e ushtruara si nga sektori i shërbimeve, ashtu dhe drejtoria e auditimit, në asnjë rast nuk ka rezultuar të ketë abuzime, përvetësim apo dëmtime të fondeve, shkeljet e gjetura kanë qenë administrative dhe për punonjësit përgjegjës janë dhënë masa disiplinore.

Kjo situatë duhet të vlerësohet duke patur parasysh që në vitet 2010-2013 ka patur raste të konsiderueshme të abuzimit me fondet e pensioneve dhe OSHEE, të cilat kanë kaluar në ndjekje penale (Përgjegjës sektori P. Z.).

Në shërbimin postar kemi patur performancë për tu vlerësuar, nuk kemi patur raste të humbjes dëmtimit të objekteve apo cilësi të dobët shërbimi.

Përsa i përket arritjes së objektivave që pretendohet se nuk është bërë punë e mjaftueshme, në faqen nr. 2 në Raportin Përfundimtar të Auditimit (që referohet masa e dhënë) janë paraqitur treguesit e realizuar për vitin 2018, sipas të dhënave të paraqitura nga grupi auditimit të ardhurat janë realizuar në masën 100.3% dhe për 10 mujorin e vitit 2019 treguesit e të ardhurave kanë qenë në të njëjtin nivel realizimi, tejkalimi i shpenzimeve ka ndikim negativ për mos arritjen e performancës së programuar, gjë për të cilën nuk është përgjegjësi e përgjegjës të shërbimeve.

Lidhur me emrimin në pozicionin që unë kam mbajtur më parë jam shprehur në ankimmimin e bërë se punonjësja e emëruar ka eksperiencë më pak se dy vite pune, ka filluar punë në dhjetor 2017. Posta Shqiptare duhet të promovojë punonjësit në baze të meritës dhe konform rregullave procedurave të përcaktuara, në këtë rast nuk e ka bërë. Posta Shqiptare në këtë shkresë ka të dhëna kontradiktore dhe të pa faktuara me akte për pretendimet e paraqitura nga ana ime në ankesën e bërë”.

5. Në vijim, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., me shkresën 1488/1 prot., datë 13.07.2021, iu kthye përgjigje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke sqaruar ndër të tjera se:

“...Duke qenë shoqëri me kapital 100% shtetëror përgjegjësia sociale kundrejt klientëve qofshin këta individë apo institucione është shumë e lartë. Posta Shqiptare sh.a., është një kompani, në të cilën është e ndaluar çdo formë diskriminimi për punonjësit e saj, e parashikuar në Kodin e Punës dhe në legjislationin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Neni 7, pika 3 “Autoritetet

publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre'...

Grupi i Auditimit në Raportin e Auditimit që i dërgon subjektit të audituar në lidhje me shkeljet dhe parregullsitë përcakton edhe personin përgjegjës sipas strukturës, ndërsa në rekomandime përcakton përmirësimin që duhet bërë, afatin kohor për zbatimin e tij dhe strukturën përgjegjëse për zbatim. Të gjitha këto pasqyrohen në Planin e Veprimit...

Punonjës të tjerë, të cilët kanë marrë masa disiplinore nga kontrolli i ushtruar në Filialin e Postës Shkodër masa të marra me Vendimin e Drejtorisë Nr.17, datë 15.01.2018, dhe dërguar në Filialin e Postës Shkodër, me shkresë nr. 2121/1 prot, datë 24.01.2018, janë:

- P. N., me detyrë Drejtor për periudhën që ka punuar me detyrë 'P. i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse' ka marrë masë disiplinore 'Vërejtje me shkrim'.
- E. V., me detyrë 'P. Shërbimeve Mbështetëse', ka marrë masë disiplinore 'Këshillim'.
- J. K., me detyrë Specialsit IT ka marrë masë disiplinore 'Vërejtje me shkrim'.
- L. L., me detyrë Punonjëse Shërbimi për periudhën që ka punuar me detyrë 'Specialiste Sigurie dhe Cilësisë e Marketingut', ka marrë masë disiplinore 'Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna'.
- E. N., me detyrë Specialiste Sigurie dhe Cilësie e Marketingut, për periudhën që ka punuar me detyrë 'Drejtorë', ka marrë masë disiplinore 'Largim nga Puna'.
- T. P., me detyrë Specialiste Shërbim Kosto, ka marrë masë disiplinore 'Vërejtje me shkrim'.
- Xh. P., me detyrë Specialiste Shërbim- Kosto, në Degën e Postës Pukë ka marrë 'Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna'.

Nga kontrolli i ushtruar në Filialin e Postës Shkodër në vitin 2019, janë rekomanduar masa disiplinore dhe për punonjës të tjerë konkretisht për:

- P. N., nuk i është rekomanduar masë disiplinore pasi është marrë masa 'Ulje në detyrë'.
- E. V., me detyrë 'Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse', i është dhënë masa disiplinore 'Vërejtje me paralajmërim', me Urdhër nr. 281, datë 21.10.2019.
- L. L., me detyrë 'ish-Specialiste e Sigurisë-Cilësisë', i është dhënë masa disiplinore 'Vërejtje me shkrim', me Urdhër Nr. 283, datë 21.10.2019.
- E. P., me detyrë 'Kryetare e Degës së Postës Pukë', i është dhënë masa disiplinore 'Vërejtje' me Urdhër Nr. 279, datë 21.10.2019;
- Xh. P., me detyrë 'Specialiste Shërbimesh në Degën e Postës Pukë', i është dhënë masa disiplinore 'Vërejtje me paralajmërim', me Urdhër Nr. 280, datë 21.10.2019.

Gjithashtu me shkresën nr. 1073/46, datë 29.01.2016, janë dërguar nga KLSH (Kontrolli i Lartë i Shtetit), 'Dërgim rekomandime dhe pjesë nga Raporti Përfundimtar', drejtuar M. L., ku në veçanti për Filialin Shkodër thuhet: Janë lënë rekomandimet...të kryejë analiza periodike dhe të veçanta të ecurisë së treguesve ekonomik dhe financiar, duke evidentuar përgjegjësitë e stafit dhe të personelit, me qëllim që të sigurohet realizimi programit të zhvillimit të filialit;

- Të bëjë përpjekjet maksimale për të mbajtur, ruajtur dhe siguruar limitin ditor të arkës, duke harmonizuar nevojat dhe shpërndarjen ditore, kohën dhe sigurinë e vazhdueshme fizike të vlerave monetare. (ky informacion është në faqen online të KLSH).

Pra, përse përmendur më sipër rezulton se në vazhdimësi aktiviteti i shërbimeve në Filialin Shkodër, Posta Shqiptare sh.a., ka qenë me performancë të ulët, e konstatuar kjo në auditimet e njëpasnjëshme, ashtu edhe në auditimin nga KLSH-së. Për këtë shkak gjatë kësaj periudhe i'u janë dhënë masa Drejtorëve/eve deri edhe në 'Largim nga detyra', si dhe janë dhënë masa disiplinore të tjera si më sipër.

Në asnjë rast znj. L. Sh. nuk është paragjykuar apo diskriminuar për shkak të përkatësisë politike, përkundrazi gjithmonë është konsideruar përvoja e gjatë në institucion...

Në lidhje me pretendimin se subjektit ankimes L. Sh. 'Nuk i është njoftuar materiali me shkeljet' nuk qëndron, pasi në zbatim të Ligjit 114/2015 'Për Auditimin e Brendshëm në Njësitë e Sektorit Publik dhe Manualin e AB 2016, Raporti final i Auditimit është pranuar nga filiali me nr. prot. 642, datë 21.05.2019 dhe është nënshkruar nga znj. L. Sh. (kopje njësuar me origjinalin nr. 1 bashkëlidhur, faqe një). Në zbatim të procedurës së AB krahas Raportit final, i cili i dërgohet subjektit të audituar, një material përmbledhës në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet për pëmirësim në formë Memorandumi i nisët Administratorit të shoqërisë.

Pretendimi i subjektit ankues L. Sh., pjesë e menaxhimit të Filialit Shkodër se, ...drejtuesit e Partisë Socialiste Shkodër i kanë bërë presion të vazhdueshëm drejtuesve të Posta Shqiptare sh.a., për largimin e saj nga puna... nuk qëndron pasi nuk ka fakte.

Pretendimi se, masa e dhënë nuk ka; a) nuk ka shkak, ju informojmë se shkak është "përsëritje të gjetjeve, në mënyrë të veçantë mos vlerësimi i riskut dhe mos funksionim i Kontrollit të Brendshëm në disa shërbime me risk të lartë, siç janë shërbimi i pagesës së pensioneve, shërbimi i arkëtimit të faturave OSHEE, shërbimi i pagesës së ndihmës ekonomike, invaliditetit, etj. Në këtë rast nuk janë përmbushur plotësisht kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin', i ndryshuar, Neni 11, 'Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike', për:

- 1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.*
- 2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.*

Si përfundim theksojmë se në zbatim të, Nenit 24 Monitorimi:

- 1. Titullarët e njësisë publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.*
- 2. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Funkcioni i auditimit të brendshëm rregullohet me ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik.*

AB si një instrument menaxherial efektiv, që ofron këshilla dhe garanci objektive e të pavarur për GMS, për titullarin, apo drejtues të tjerë, lidhur me faktin se sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit janë vendosur në përputhje me rregullat dhe standardet si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Posta Shqiptare sh.a. është në procesin e implementimit tërësisht të kërkesave të Ligjit të MFK dhe manualit të tij duke ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik dhe vendosur Koordinatorin e Riskut si dhe të caktojë, një mekanizëm të përshtatshëm për tërheqjen e vërejtjeve lidhur me gjetjet e AB dhe rekomandimet e tij.

Në këtë kuadër do të përmirësohet Procedura e dhënies së masave disiplinore dhe administrative si dhe e vetvlerësimit, vlerësimit të punës së çdo punonjësi dhe strukture. Kjo do të thotë që Vlerësimi i punonjësve do të bëhet në vazhdimësi për të parë performancën e tyre dhe rishikimin e pozicioneve të punës, gjithmonë bazuar në performancë. Ky proces është dinamik pasi edhe mjedisi i kontrollit është në ndryshim të vazhdueshëm, informatizimi i proceseve kërkon rritjen e aftësive të punonjësve për përdorimin e tij dhe krijon kushte që menaxherët të shpenzojnë më shumë kohë në zyra postare duke kontrolluar direkt në sportelin, zyrën ku kryhet shërbimi si dhe duke kontaktuar ballë për ballë klientin.

Përgjegjësia kryesore e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a është kryerja e shërbimit në kohë, me cilësi dhe kudo.”

Bashkëlidhur Posta Shqiptare vuri në dispozicion të KMD-së:

- Kontratën Individuale të punës të L. Sh.
- Kontratën Kolektive të lidhur mes Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare me nr. 123 prot., datë 08.07.2019 dhe Postës Shqiptare nr.1887 prot, datë 08.07.2019.
- Pjesë të Raportit Final dhe Pjesë e Raportit të Auditimit “Mbi përfundimet e angazhimit të auditit” dërguar Filialit të Postës Shkodër, shkresë nr. 483/4 prot, 01.09.2019, të Drejtorit të Filialit (pjesa e Shërbimeve dhe Marketingut).
- Plan Veprimi dërguar Filialit Shkodër.
- Vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë nr. 17, datë 15.01.2018 mbi “Auditimin e plotë ekonomiko-financiar dhe të shërbimeve të kryer në Filialin e Postës sh.a., Shkodër”.
- Vendimin e Drejtorisë Nr. 310, datë 30.11.2015 “Mbi Auditimin e pjesshëm ekonomiko-financiar të Filialit Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Korçë e Lezhë”.
- Masa disiplinore 212/1 prot, date 24.01.2018 “Dërgohen masa disiplinore për zbatim në Filialin e Postës sh.a. Shkodër”.
- Masat disiplinore në Filialin e Postës Shkodër.
- Pjesë e Rregullores se Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Qendrore të Shoqërisë Posta Shqiptare” mbi detyrat e funksioneve të cekura në këtë material.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Nga informacioni i administruar, rezulton se ankuesja, është emëruar ekonomiste në Administratën e Postës Shqiptare sh.a. dhe ka vijuar të punojë në këtë institucion që prej vitit 1986. Më datë 16.12.2013, me shkresën nr. 704 prot., ankuesja është liruar nga detyra Specialiste Shërbimesh dhe është emëruar Kryetare e Degës së Shërbimeve dhe Marketingut, në Filialin e Postës sh.a. Shkodër.

Gjatë vitit 2018, pranë Filialit të Postës sh.a. Shkodër, është kryer një proces auditimi ekonomiko-financiar. Në përfundim të këtij procesi, Drejtoria e Postës Shqiptare sh.a., pas konsultimit të memorandumit të paraqitur nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, me Vendimin Nr. 17, datë 15.01.2018, vendosi:

1. Të miratojë dhënien e masave disiplinore për punonjësit e poshtëshënuar në Filialin e Postës sh.a. Shkodër:
 - Për ish Drejtoreshën E. N., aktualisht Specialiste Sigurie, Cilësie e Marketingu *“Largim nga puna”*;
 - Për Drejtorin, P. N. (për një pjesë të periudhës së audituar ka qenë Përgjegjës i Burimeve Njerëzore e Administratës), *“Vërejtje me shkrim”*;
 - Për Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimeve E. V., *“Këshillim”*;
 - Për Përgjegjësen e Shërbimeve dhe Marketingut, L. Sh., *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”*;

Në vijim, Posta Shqiptare sh.a., me shkresën nr. 212/1 prot., datë 24.01.2018, ka dërguar pranë Filialit të Postës sh.a. Shkodër, masat disiplinore të sipërcituara për zbatim, si dhe veç punonjësve të sipërcituar, ishin vendosur edhe masa të tjera si më poshtë vijon:

1. Për punonjësin J. K., me detyrë Specialist IT në Filialin e Postës sh.a. Shkodër, masa disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*;
2. Për punonjësen L. L., me detyrë Punonjëse Shërbimi, për periudhën që ka punuar me detyrë Specialiste Sigurie/Cilësie e Marketingut, në Filialin e Postës sh.a. Shkodër, masa disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”*.

Pavarësisht përsa sipërcituar, mbështetur në provat e administruara, pak kohë pas masës disiplinore të dhënë, më datë 23.03.2018, mes ankueses dhe Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., L. D., është nënshkruar Kontrata Individuale e Punës, në të cilën ajo është punësuar në detyrën Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut, në Filialin e Postës sh.a. Shkodër.

Në vijim, gjatë vitit 2019, në Filialin e Postës sh.a. Shkodër dhe degët e saj, referuar shkresës nr. 483/4 prot., datë 01.09.2019, është realizuar një auditim i plotë ekonomiko-financiar dhe të shërbimeve, për periudhën 01.10.2017-31.01.2019. Nga auditimi i kryer në Filialin e Postës Shkodër, janë konstatuar disa parregullësi, për të cilat Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., me shkresën nr. 236/B prot., datë 16.10.2019, ka rekomanduar masat disiplinore si më poshtë vijon:

- Për ish Drejtorin P. N., nuk është rekomanduar masë pasi për të është marrë më parë masa e uljes në detyrë;

- **Për Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut, L. Sh., është rekomanduar masa disiplinore referuar nenit 21.2 (pika 5 ose 6) e Kontratës Kolektive të Punës;**
- Për Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, E. V., është rekomanduar masa disiplinore referuar nenit 21.2 (pika 3 ose 6) e Kontratës Kolektive të Punës;
- Për Kryetaren e Zyrës Qendër Shkodër, L. L., është rekomanduar masa disiplinore referuar nenit 21.2 (pika 2 ose 3) e Kontratës Kolektive të Punës;

Në Kontratën Kolektive të Punës, së lidhur ndërmjet Postës Shqiptare sh.a. dhe Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare, me Nr. 1887 prot., datë 08.07.2019, në Nenin 21 parashikohen masat disiplinore dhe administrative. Në pikën 21.2 të saj, parashikohet se: *“Për shkelje disiplinore, punëdhënësi i jep punëmarrësit një nga masat e mëposhtme:*

1. *Këshillim;*
2. *Vërejtje;*
3. *Vërejtje me shkrim;*
4. *Pezullim nga e drejta për t’u ngritur në detyrë deri në 1 vit;*
5. ***Ulje në detyrë;***
6. ***Vërejtje me paralajmërim;***
7. *Zgjidhje e marrëdhënies së punës.”*

Pra, referuar përcaktimeve në Kontratën Kolektive, nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., ndaj ankueses ishte rekomanduar një prej masave disiplinore: *“5. Ulje në detyrë”* ose *“6. Vërejtje me paralajmërim”*.

Në këtë kuadër dhe referuar rekomandimeve të dhëna nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Postës Shqiptare sh.a., urdhëroi dhënie mase disiplinore në Filialin e Postës sh.a. Shkodër, për punonjësit:

1. Me Urdhërin Nr. 282, datë 21.10.2019, L. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut, i jepet masa disiplinore *“Ulje në detyrë”*. (ishte rekomanduar *“5. Ulje në detyrë”* ose *“6. Vërejtje me paralajmërim”*).
2. Me Urdhërin Nr. 283, datë 21.10.2019, L. L., me detyrë ish Specialiste e Sigurisë, Cilësisë dhe Standardeve, i jepet masa disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*. (ishte rekomanduar *“2. Vërejtje”* ose *“3. Vërejtje me shkrim”*).
3. Me Urdhërin Nr. 281, datë 21.10.2019, E. V., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, i jepet masa disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim”*. (ishte rekomanduar *“3. Vërejtje me shkrim”* ose *“6. Vërejtje me paralajmërim”*)

Referuar pikës 21.4, të Nenit 21 të Kontratës Kolektive të Punës, masat disiplinore jepen në përputhje me rëndësinë e shkeljes, mundësisht të shkallëzuara. Dhënia e shkallëzuar e masave disiplinore nuk ruhet në rastet e shkeljes me faj të rëndë të punëmarrësit ose të përsëritjes së shkeljes.

Pra, në analizë të informacionit të administruar, rezulton se ankuesja pavarësisht faktit që në fillim të vitit 2018, është ndëshkuar me masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, ndaj saj nuk ka patur ndonjë veprim të përshkallëzuar për ta larguar nga puna, por referuar Kontratës Individuale të Punës, më datë 23.03.2018 ajo është emëruar në detyrën Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut.

Gjithashtu, edhe pas rekomandimeve të bëra nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., për ankuesen është ndërmarrë masa disiplinore e një shkalle më të lehtë se ajo e rekomanduar. Ndërsa, po t’i referohemi rasteve të tjera të ngjashme, të rekomanduara nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Postës Shqiptare sh.a., për punonjëset L. L. dhe E. V., Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Postës Shqiptare sh.a., ka urdhëruar marrjen e masave më të rënda të rekomanduara.

Lidhur me faktimin e performancës së ankueses, në kronologji të ngjarjeve dhe veprimeve të punëdhënësit, Komisioneri konstaton se shoqëria Posta Shqiptare sh.a. ka provuar nëpërmjet informacionit dhe dokumentacionit të depozituar, se ankuesja dhe sektori të cilin ajo drejton, ka patur parregullësi të konstatuara nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të shoqërisë.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Pavarësisht faktit që ankuesja ka patur një masë disiplinore të rëndë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, nga ana e Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., 2 (dy) muaj pas dhënies së saj, është nënshkruar Kontrata Individuale e Punës për vijimin e ushtrimit të detyrës së Përgjegjëses së Shërbimeve dhe Marketingut;
- Nga ana tjetër, pavarësisht faktit që Drejtoria e Auditit të Brendshëm, kishte rekomanduar 2 (dy) mundësi për dhënie të masave disiplinore, ndaj ankueses, në krahasim me koleget e saj, i është dhënë masa më e lehtë nga ato të rekomanduara nga auditi;

Përsa më sipër, referuar informacionit dhe provave të administruara, nuk evidentohet se Posta Shqiptare sh.a., ka vënë në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme ankuesen në raport me kolegët e tjerë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi.”

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në

nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Posta Shqiptare sh.a., për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, L. Sh., në të drejtën për punësim, nga ana e Posta Shqiptare sh.a., për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)